



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2021, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR SUBVENCIONIMIN E KOMPANIVE PRIVATE QË OPEROJNË ME AUTOBUSË**  
**NË LINJAT E TRANSPORTIT PUBLIK URBAN**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për subvencionim direkt të kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e transportit publik urban.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 400,000.00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, 22/616/16306, mjete nga të hyrat vetanake.

**III.**

Qëllimi i këtij Vendimi është dhënia e ndihmës kompanive private që operojnë me autobusë në linjat e trafikut publik urban, për shkak të situatës pandemike të krijuar nga virusi COVID -19 dhe masave restriktive nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**IV.**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

**V.**

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-450/03-87845/21, më 19.05.2021

**KRYESUESI PËR KUVENDIN**  
Agim Kuleta

